



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-76993
Më 10.5.2016

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2016 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit, për realizimin e projekteve të përbashkëta me QRTK-në (bashkëfinancim), dhe mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e realizimit të projekteve të përbashkëta me bashkëfinancim me Qendrën për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore (QRTK-në), në Zonën Historike të qytetit të Prizrenit në projektet: restaurim, konservim, rehabilitim të objekteve-komplekseve, etj., kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, QRTK, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-76993
Më 10.5.2016

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 10 maj 2016 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e shpalljes së tenderit, për restaurimin e rrugicave në Qendrën Historike të qytetit të Prizrenit, dhe mori këtë:

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e restaurimit të rrugicave në Zonën e Qendrës Historike të qytetit të Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, QRTK, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79684
Më 10.5.2016

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për organizimin e festivalit “Nibet Fest 2016”, kryetari i Komunës më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i bazuar në kërkesën e OJQ “Katedra Slobodnog Uma”, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për shënimin dhe organizimin e festivalit tradicional të muzikës folklorike “Nibet Fest 2016”, që organizohet në fshatin Gërinqar, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 1000 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, OJQ-ja e lartcekur, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79692
Më 10.5.2016

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b dhe h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e planifikimit (ndarjes) të një kodi buxhetor në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2017-2019 të Komunës së Prizrenit, me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për tërë qytetarët e komunës së Prizrenit.
2. Ky Vendim i rekomandohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
3. Obligohet Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, së bashku me organet tjera kompetente, që, pas marrjes së këtij Vendimi, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa në Kuvendin e Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, KPF, KK, si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79702
Më 10.5.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 19 pacientëve, kryetari i Komunës më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1. Hamdi Elshani, 2. Radije Gashi, 3. Ramush Badalli, 4. Afife Latifi, 5. Fazli Destan, 6. Ilmit Bajrami, 7. Mejdin Aliji, 8. Ismail Islami, 9. Medije Berisha, 10. Drita Gashi, 11. Neviz Skenderi, 12. Suzana Qukiqi, 13. Velija Mehmedi, 14. Rahime Zogaj, 15. File Muqaj, 16. Ajsha Sopaj, 17. Estrar Kasemi, 18. Muharrem Qerpani, 19. Sadik Bytyqi.
2. Për këtë qëllim, lejohen mjetet në vlerë prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve të Drejtorisë së Shëndetësisë.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79704
Më 10.5.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b dhe d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve, për mbështetje financiare për trajtim mjekësor të Kimete Hoxhës, deputete e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit-trajtimit mjekësor, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën prej 1000 €.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve, mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79707
Më 10.5.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës me 10 maj 2016, miratoi këtë:

AKTVENDIM

1. Emërohen nga një anëtar nga ana e Drejtorive komunale në implementimin e Planit Akcional të Strategjisë Komunale për Komunitete dhe Kthim 2016-2020.
2. Anëtarë të cilët emërohen janë:
 - 2.1. Drejtori i Drejtorisë së Administratës,
 - 2.2. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës,
 - 2.3. Drejtori i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit,
 - 2.4. Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - 2.5. Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike,
 - 2.6. Drejtori i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,
 - 2.7. Drejtori i Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrës,
 - 2.8. Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
 - 2.9. Drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - 2.10. Drejtori i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - 2.11. Drejtori i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë.
3. Detyrat e anëtarëve të emëruar është implementimi i Planit Akcional të Strategjisë Komunale për Komunitete dhe Kthim 2016-2020 pas miratimit të të njëjtit nga ana e Kuvendit të Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, anëtarët –Drejtoritë përkatëse.
5. Me këtë Aktvendim të njoftohen Zyra për Komunitete dhe Kthim, anëtarët – Drejtoritë përkatëse, si dhe Arkivi.
6. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kryetari i Komunës

Nr. 01/011-79711

Më 10.5.2016

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit Njesisë për të Drejtat e Njeriut për lejimin e mjeteve për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve -1 Qershori, kryetari i Komunës, më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Njesisë për të Drejtat e Njeriut, për lejimin e mjeteve financiare për organizimin dhe shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve -1 Qershori, kështu që, për realizimin e këtij manifestimi tradicional, lejohen mjetet financiare në shumën prej 900 €.
2. Ky organizim do të bëhet në bashkëpunim edhe me Asamblenë e Fëmijëve të qytetit të Prizrenit.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
5. Me këtë Vendim të njoftohen: Njësia për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Pop. tr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79714
Më 10.5.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për OJQ “Finch”, kryetari i Komunës më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për OJQ “Finch” për organizimin e takimeve që kanë të bëjnë sensibilizimin dhe vetëdijesimin e opinionit për mbrojtjen e shpezëve të egra, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 660 €.
2. Shuma e lejuar e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës, pozicioni i subvencioneve dhe mallrave të shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publiket, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Shoqata-OJQ-ja, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79716
Më 10.5.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, të Vendimit nr. 06/83 datë 6.4.2016 të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, kryetari i Komunës më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqit natyrore në pronat dhe kulturat bujqësore për muajin janar 2016, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet financiare në shumën prej 13.270 €. (25% nga vlera e përgjithshme e dëmit prej 53.086,50 € për 42 fermerë sipas regjistrimit nr. 10-320-17315 datë 1.02.2016).
2. Shuma e lejuar e përshkruar në nenin 1 të këtij Vendimi është siguruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe të njëjtat janë transferuar në buxhetin e Komunës së Prizrenit- kategoria ekonomike subvencione dhe transfere në programin “Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural” nën-programi ”Bujqësia”.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria përkatëse, përfituesit, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-79719
Më 10.5.2016



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Republikën e Shqipërisë dhe pagesës së mëditjeve për Islam Elshanin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës më 10 maj 2016, miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Islam Elshanit, zyrtar komunal, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që ka të bëjë me projektin rajonal për të drejtat sociale, për grupet e cenueshme-margjinalizuara. Vizita-trajnimi do të realizohet nga data 18 maj deri më 20 maj 2016, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe Arkivi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. Dr. Ramadan Muja